

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 27, datë 23.09.2021

Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 02, datë 29.01.2021 “Për miratimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes së Audituesit të Jashtëm të Specializuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për vitet financiare 2021 - 2024

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 79, pika 4 të Ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 6, pika 2, shkronja “e”, të nenit 19 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Në aneksin me titull “Termet e referencës dhe kriteret e përzgjedhjes të audituesit të jashtëm të specializuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për vitet financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021, 2022, 2023, 2024”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 02, datë 29.01.2021, në seksionin XV “Kriteret e kualifikimit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nëntitullin “Kapaciteti financiar dhe ekonomik”, pika 1 riformulohet me përmbajtjen si vijon:



KËSHILLI DREJTUES

“Një kopje të bilancit të tre viteve të fundit (2018, 2019 dhe 2020), të vërtetuar nga zyra e tatim taksave, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

- b) Në nëntitullin “Kapaciteti financiar dhe ekonomik”, pika 2 riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë sa 40% e fondit limit që prokurohet.”

- c) Në nëntitullin “Kapaciteti teknik”, pika 3 riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“Operatori ekonomik duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së Agjencisë, duhet të ketë eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të bankave që operojnë në Shqipëri, Bankës së Shqipërisë ose Agjencisë, të cilat mbajnë kontabilitetin sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar këtë kusht:

- Kur shërbimi është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.
- Kur shërbimi është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”



KËSHILLI DREJTUES

2. Ngakohet njësia e prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar